



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR PROKURIMIN ME OBJEKT:

SHËRBIM KONSULENCË PËR VLERESIM TE ASETVEVE DHE PREGATITJEN E DOKUMENTACIONIT PER SHITJEN ME ANKAND TE AKSIONEVE TE BASHKISE SHKODER TEK KLUBI I FUTBOLLIT “VLLAZNIA” SH.A.

HYRJE

Futbolli shqiptar i ka fillimet e hershme që pas pavaresisë së Shqipërisë. Shkodra është origjina e lindjes së futbollit në vendin tonë. Për herë të parë luhet futboll në vitin 1908, kohë kur lagjet e vjetra shkodrane filluan të ndesheshin ndërmejet tyre duke krijuar një interes të veçantë në popullsinë e asokohe. Ndërsa topi i parë i vërtetë i futbollit në Shqipëri u soll në Shkodër nga prifti maltez At Gutt Ruter.

Në këtë mënyrë, duke parë interesimin e madh ndaj këtij sporti filluan të krijoheshin grupe të vogla sportive të cilët më vonë do të krijonin shoqëri sportive. Shoqëria Vllaznia është themeluar me 16 shkurt të vitit 1919, ku nismëtarët ishin anëtarët e shoqatës “Mustafa Pasha” dhe “Vaso Pasha” të cilat u bashkuan për të krijuar një shoqëri të vetme me emrin “Vllaznia”. Ndër themeluesit e shoqërisë “Vllaznia” mund të përmendim emrat e Hilë Mosit që u zgjodh kryetar, Hysen Draçini nënkryetar e Jonuz Tafili sekretar. Kjo shoqëri luajti një rol shumë të madh në zhvillimin e llojeve të ndryshme të sportit si: futbollit, çiklizmit, atletikës, hipizmit etj. Kjo shoqëri do të ishte e para shoqëri sportive në të gjithë Shqipërinë.

Klubi i futbollit “Vllaznia” ka lënë gjurmë në historinë e futbollit të vendit tonë. Një histori e tërë e saj, kaluar përmes suksesesh e peripecish që kanë lënë mbresa. Mbi të gjitha ka lënë të shkruar në historinë e sportit të futbollit shqiptar shumë emra e personazhe që kanë të bëjnë pikërisht me këtë klub. Më 1913 luhet në Shkodër ndeshja e parë ndërkombëtare e futbollit për vendin tonë mes skuadrës “Indipendenca” dhe një formacioni Austro – Hungarez.

Më vonë do të krijoheshin edhe klubet e tjera si Skenderbeu, Tirana, Flamurtari, Teuta etj. Në vitin 1930 të gjitha ekipet e krijuara do të themelonin Federatën Shqiptare të Futbollit. Po në këtë vit do të luhej edhe Kampionati i parë Shqiptar profesionist në të cilën morën pjesë 6 skuadra ku padyshim Vllaznia ishte një ndër nismëtarët dhe pretendentët e atij edicioni futbollistik. Vllaznia gjithashtu do të jetë edhe finaliste në edicionin e parë të kupës së Shqipërisë, të organizuar në vitin 1938, ku do të ndeshet me Tiranën e cila triumfoi.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, aktivitetet sportive rezultojnë të ndërprera, për të rifilluar përsëri pas luftës. Pas vitit 1945 për klubin e futbollit Vllaznia rinisin sfidat e reja. Pikërisht, ndër këto vite dhe saktësisht 1945 dhe 1946 Vllaznia do të fitojë 2 herë radhazi Kampionatin Shqiptar, biles në vitin 1946 Vllaznia shënon një rekord duke i fituar të gjitha ndeshjet, duke marrë kështu 100% të pikëve të mundshme. Në këto vite janë për t’u përmendur lojtarët me famë të futbollit shkodran dhe të mbarë atij shqiptar, si Loro Boriçi, Muhamet Dibra, Xhelal Juka, Bimo Fakja, Met Vasija e shumë e shumë të tjerë. Në vitet në vazhdim Vllaznia paraqitet gjithmonë si pretenduese duke qenë ekipi i vetëm nga rrethet që konkuronte me sukses ndaj treshes së ekipeve të kryeqytetit, Tirana, Dinamo dhe Partizani.

Në edicionet e viteve '71-'72 Vllaznia është rikthyer përsëri fituese, si e Kupës së Shqipërisë po ashtu edhe e Kampionatit. Sipas rradhës edhe emrat e ekipit kampion të atij edicioni: Z. Ndoja, Z. Basha, Duraj, Lekaj, M. Dedja, Rragami, Bizi, R.Çanga, Rakiqi, Hoxha, Ç. Ndoja, Zhega, Plumbini, Puka, Koçobashi, Dani. Trajner: Xh. Shaqiri. Janë po ai brez i talentuar lojtarësh me emër që rifitojnë titullin kampion të Shqipërisë përsëri, brenda një kohe shumë të shkurtër, pikërisht në edicionin '73-'74 dhe '77-'78. Në vitin 1978 Vllaznia do të marrë pjesë në kupat europiane.

Edhe në vitet më pas Vllaznia ka vazhduar të jetë protagoniste në futbollin shqiptar, duke fituar kupën e Shqipërisë si në vitin 1979 ndaj Dinamos ashtu edhe në vitin 1981 ndaj Besës. Gjithashtu, në vitin '82-'83 Vllaznia do të shpallet fituese edhe e kupës dhe e kampionatit. Ndër ato vite, Vllaznia ka vazhduar të jetë protagoniste, duke arritur në gjysëmfinale dhe finale disa herë por duke u mundur gjithmonë nga ekipet e kryeqytetit.

Pas viteve '90, pavarësisht nga situatat e vështira që përjetonte i gjithë vendi dhe sporti shqiptar, me ndërrimin e sistemeve politike dhe ekonomike në vend, Shkodra ka treguar që e do me shpirt futbollin dhe Vllazninë, falë lojtarit të dymbëdhjetë, arrin të shpallet përsëri Kampion e Shqipërisë për edicionin '91-'92. Emrave të shquar të historisë së futbollit i shtohen edhe ato të asaj skuadre kampionë: Dani, Nako, H. Dedja, Pashaj, Shpuza, Noga, Ç. Basha, Premçi, Bushati, A. Gruda, Billa, Ymeri, Tepelia, Bisha, Hoxha, Lika, Martini, Keçi, Filipi. Trajner: A. Hafizi.

Në vitin 1998 Vllaznia mund Apolloninë dhe fiton edhe superkupën e Shqipërisë, duke treguar se është ekipi më i mirë i atij viti. Sukseset e Vllaznisë kanë vazhduar edhe në vitet më vonë. Sezoni 2000-2001 ka qënë i jashtëzakonshëm, në ndeshjen e fundit të atij edicioni, stadiumi "Loro Boriçi" me mbi 16 000 spektatorë ka festuar titullin së bashku me skuadrën, pas ndeshjes së fundit të fituar nga Vllaznia me rezultatin 6-4.

Ekipi i rikthehet fitoreve pas disa vitesh në sezonin 2007-2008 ajo arrin të shkëlqejë në Kupën e Republikës, në të cilën arrin të marrë "hakun" e edicionit të kaluar ndaj Tiranës, duke rikthyer në Shkodër Kupën e Republikës mbas 10 viteve. Në 2008 Vllaznia merr pjesë në kupën Uefa ku arrin të kualifikohet në turin e parë kurse në turin e dytë Vllaznia luan kundër skuadrës italiane Napoli të cilat i humb të dyja.

K.F Vllaznia është 9 herë kampion e Shqipërisë dhe 11 herë nënkampion. Ajo ka fituar 6 herë kupën e Shqipërisë dhe 8 herë ka qënë finaliste. Ka fituar 2 herë Superkupën në vitin 1998 dhe në 2001 ndërsa në vitet 1992 dhe 2008 ka qënë finaliste. Numri i madh i vendeve të para dhe të dyta, tregon forcën dhe suksesin e Vllaznisë ndër vite, gjithmone si një ndër protagonistet e vërteta të sportit të futbollit në vendin tonë.

Klubi i Futbollit Vllaznia me NIPT L17029001S, është themeluar si shoqëri aksionare me dt. 29.8.2011 si shoqëri aksionare, me aksionar te vetem 100% Bashkia Shkoder dhe me nje kapital fillestar prej 2.000.000 leke me vlere nominale te nje aksioni 1.000 leke, me objekt veprimtarie:

Organizimi i aktiviteteve ne fushen e futbollit. Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesmarrja ne garat sportive te organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit. Aderimi dhe rregjistrimi si klub Federaten Shqiptare te Futbollit, dhe ne te gjitha llojet e aktiviteteve te futbollit kombetar dhe nderkombetar. Futja ne tregun e lojtareve sipas nevojave te ekipit. Aktivitete te tjera ne fushen e futbollit per interesat e shoqerise dhe Bashkise. Shoqeria, brenda kufijve te parashikuara nga legjistacioni ne fuqi, do te kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar qe

lidhet drejtpërdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet perkates”

K.F Vllaznia vazhdon nën administrimin e Bashkisë Shkodër e cila zoteron 100% të aksioneve.

Sot, KF.Vllaznia zotëron një kapital 320.322.000,00 lekë .
Megjithatë Bashkia Shkoder ka investuar vazhdimisht tek Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a, ky investim ka rezultuar me humbje të mëdha për shkak të manexhimit jo korrekt ndër vite.

Bashkia Shkoder, gjatë gjithë këtyre viteve, nuk ka siguruar asnjë dividend nga investimet e kryera tek Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a.

Investimet e kryera tek ky klub nëpërmjet rritjes së numrit të aksioneve dhe e kapitalit, tashmë janë të paperballueshme për buxhetin modest të Bashkisë Shkodër.

Gjendja ekonomike e Klubit të Futbollit “Vllaznia” sipas bilancit të vitit 2016 është bashkelidhur.

Humbja e këtij klubi ka ardhur vazhdimisht duke u thelluar sipas viteve, duke arritur në shifra prej 308.350.378 leke.

Bashkia Shkoder mendon se është e nevojshme që KF. Vllaznia sh.a, si një klub me kërkesa të mëdha financiare, t’i krijohet mundësia e një administrimi me të pershtatshëm nëpërmjet PRIVATIZIMIT të tij. Privatizimi lind si nevojë për ta fuqizuar KF. Vllaznia sh.a. Historiku i këtij klubi tregon se përpara se ta merrte administrimin bashkia, sponsorët kanë arritur ta mbajnë KF. Vllaznia në nivel të lartë, në vendet e para të klasifikimit, madje duke fituar edhe trofe dhe duke marrë pjesë në Kupat e Europës. Privatizimi i klubit është një domosdoshmëri për ta rikthyer këtë klub kryesues në tabelën e renditjes. Gjithashtu dhe tifozëria shkodrane mirepritet një proces i tillë privatizimi, si një potencial për të bashkuar më shumë burime financiare, menaxheriale e teknike në dobi të skuadrës së zemrës e cila i ka dhuruar emocione dhe ato e kanë duartrokitur me breza.

METODA E SUGJERUAR

Nga metodat e ndryshme që përdoren sot për vlerësimin e shoqërive sportive, për kushtet e Vllaznise, sikurse u sqarua më sipër, **sugjerojmë që të përdoret metoda “Multivariate model”** dhe jo metoda “ Discounted cash flow” ose metoda të tjera që mbivlerësojnë të ardhurat dhe rezultatin financiar të klubit.

Sipas kësaj metode duhet të mbështetemi në shumë faktore relevante, e kryesisht në tre faktore:

- a. “Të ardhurat“ (Revenues),
- b. “Rezultatet“ (Sportive result) dhe,
- c. “Tifozëria” (Consumers).

Këto tre faktorë janë ngushtësisht të lidhur me njëri-tjetrin sepse rritja ose përmirësimi i njërit prej tyre favorizon dhe rritjen e dy të tjerëve.

- a. **Të ardhurat:** *Këtu duhet të jepen të gjitha të dhenat ekonomike të klubit për një periudhë të pakten 5-vjeçare (të ardhurat nga stadiumi, të ardhurat komerciale, të drejtat televizive, të ardhurat nga kontratat për sponsorizime dhe publicitet, të ardhurat nga fushata e transferimit të lojtarëve etj.)*

Tabele 1: Të ardhura të ndryshme në vite:

leke

Të ardhurat nga:	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Bileta	2,190,600	1,591,099	450,500	2,667,812
Reklama	4,010,000	1,300,000	-	1,577,711
Sponsorizime	-	1,200,000	490,248	-
Shitje lojtarësh	-	-	9,819,878	2,500,000
Drejta televizive	6,700,000	7,000,000	7,000,000	7,208,000
Formimi i lojtarëve	-	-	2,139,770	-
Brand value	-	-	-	-
Bashkia Shkoder		44,000,000	57,822,000	62,000,000

Rezultatet financiare të shoqërisë (Bilancet vjetore të shoqërisë, përfshirë asetet e tij, PASH, Cash flow, Pasqyra e ndryshimeve në kapital etj). Janë të publikuara në faqen e QKB <http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

Shoqërisë fituese, do t'i jepen të gjitha të dhenat e tjera ose sqarime që mund të kerkohen prej saj dhe që i nevojiten për përmbushjen e kontratës që do të lidhet mes saj dhe Bashkisë Shkoder.

b. **Rezultatet:**

1. Tabele 2 UEFA team ranking

Rank	Club	0.250	0.500	0.750	1.000	1.250	1.500	1.750	2.000	Total
386	Vikingur Reykjavik	0.250	0.500	0.750	0.475	0.200				1.925
386	Fram Reykjavik	0.250	0.500	0.750	0.225	0.200				1.925
389	Renova Dzepciste	0.750	0.100	0.225	0.550	0.250				1.875
389	FK Turnovo	0.250	0.600	0.475	0.300	0.250				1.875
391	Atlantas Klaipeda	0.225	0.250	0.600	0.400	0.350				1.825
391	FK Süduva	0.725	0.500	0.100	0.150	0.350				1.825
391	FK Mogren	1.100	0.275	0.250	0.150	0.200				1.975
391	KF Tirana	0.650	0.400	0.175	0.425	0.175				1.825
394	Uni College Dublin	0.200	0.050	0.400	0.640	0.525				1.815
395	Kalev Sillamäe	0.075	0.200	0.800	0.450	0.275				1.800
396	FC Lahti	0.400	0.100	0.480	0.450	0.350				1.780
396	TPS Turku	0.400	0.350	0.480	0.200	0.350				1.780
398	FC Banants	0.175	0.225	0.575	0.325	0.475				1.775
398	Gandzasar Kapan	0.675	0.475	0.075	0.325	0.225				1.775
398	Torpedo Kutaisi	0.550	0.625	0.250	0.125	0.225				1.775
398	Olimpi Rustavi	0.800	0.375	0.250	0.125	0.225				1.775
400	KF Vllaznia	0.675	0.150	0.400	0.175	0.425				1.825
402	FC Lusitanos	0.500	0.567	0.100	0.283	0.283				1.733
403	Glenavon	0.200	0.175	0.525	0.400	0.350				1.650
404	FK Trakai	0.225	0.250	0.100	0.650	0.350				1.575
405	SP Tre Penne	0.500	0.567	0.000	0.000	0.500				1.566
405	La Fiorita	0.250	0.317	0.500	0.250	0.250				1.566

2. Pikët e fituara në kampionatet e fundit

Klasifikimi 2011 - 2012

KF VLLAZNIA: Renditja në vendin e 6-të me 35 pikë.

Klasifikimi 2012 - 2013

KF VLLAZNIA: Renditja në vendin e 6-të me 38 pikë.

Klasifikimi 2013 - 2014

KF VLLAZNIA: Renditja në vendin e 8-të me 45 pikë.

Klasifikimi 2014 - 2015

KF VLLAZNIA: Renditja në vendin e 7-të me 35 pikë.

Klasifikimi 2015 - 2016

KF VLLAZNIA: Renditja në vendin e 6-të me 39 pikë.

Klasifikimi 2016 - 2017

KF VLLAZNIA: Renditja në vendin e 6-të me 40 pikë.

3. Titujt kombëtar të fituar.

KAMPIONATI KATEGORIA SUPERIORE

- Titujt Kampion **9 (Nente)**: 1945, 1946, 1971/1972, 1973/1974, 1977/1978, 1982/1983, 1991/1992, 1997/1998, 2000/2001.
- Titujt Nenkampion **11 (Njembdhjete)**: 1932, 1933, 1936, 1937, 1947, 1949, 1974/1975, 1996/1997, 1998/1999, 2002/2003, 2008/2009.

KUPA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- Fituese e Kupes **6 (Gjashte)** here: 1964/1965, 1971/1972, 1978/1979, 1980/1981, 1986/1987, 2007/2008.
- Finaleste e Kupes (Vendi i dyte) **8 (Tete)** here: 1938/1939, 1965/1966, 1967/1968, 1985/1986, 1998/1999, 2005/2006, 2009/2010.

SUPERKUPA E SHQIPËRISË

- Fituese e Superkupes 2 (Dy) here: 1998, 2001.
- Finaliste e Superkupes (Vendi i dyte) 2 (Dy) here: 1992, 2008.

4. *Pjesemarrja në kupat e Europës.*



Europa League Cup - Ndeshjet e Ekipit "VLLAZNIA" - 2007-2008

Java	Data	Brenda/Jashtë	Ndeshjet e Luajtura	Rez.
Turni i Parë	2007	B	NK Zagreb	1:0
Turni i Parë	2007	J	NK Zagreb	1:2
Turni i Dytë	2007	B	Trabzonspor	0:4
Turni i Dytë	2007	J	Trabzonspor	0:6




Europa League Cup - Ndeshjet e Ekipit "VLLAZNIA" - 2008-2009


Java	Data	Brenda/Jashtë	Ndeshjet e Luajtura	Rez.
Turni i Parë	2008	J	FC Koper	0:0
Turni i Parë	2008	B	FC Koper	2:1
Turni i Dytë	2008	B	S.S.C. Napoli	0: 3
Turni i Dytë	2008	J	S.S.C. Napoli	0:5

Europa League Cup - Ndeshjet e Ekipit "VLLAZNIA" - 2009-2010

Java	Data	Brenda/Jashtë	Ndeshjet e Luajtura	Rez.
Turni i Parë	2009	J	Sligo Rovers	1:1
Turni i Parë	2009	B	Sligo Rovers	2:1
Turni i Dytë	2009	B	Rapid Wien	0: 3
Turni i Dytë	2009	J	Rapid Wien	0:5

Europa League Cup - Ndeshjet Kualifikuese të Ekipit "VLLAZNIA" - 2011-2012

Java	Data	Brenda/Jashtë	Ndeshjet e Luajtura	Rez.
Turni i Parë	30.06.2011 20:30	J	 Birkirkara FC	1:0 (1:0)
Turni i Parë	07.07.2011 19:00	B	 Birkirkara FC	1:1 (1:1)
Turni i Dytë	14.07.2011 20:30	B	 FC Thun	0:0 (0:0)

Turni	i	21.07.2011	19:30	J		FC Thun	1:2 (1:0)
Dytë							

c. Tifozeria

1. *“CatchA”, qe eshte shuma e popullsisë së qendrave (qyteteve ose fshatrave ku eshte qendra e Bashkise) si dhe të Bashkive të qarkut të Shkodrës dhe e popullsisë totale të këtyre Bashkive.*

Shkodra është qytet dhe bashki në Shqipërinë Veriperëndimore, ajo është një me rëndësi gjeostrategjike e Ballkanit Perendimor, prej pranëvënies mes malësive, liqenit, detit dhe rrugëve. Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë Shkodër është dyfishuar, aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 203,633 banorë, përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 56% të popullsisë (113,501 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 23,616 banorë.

Nr	Njësia Administrative	Nr. i banorëve	Nr.familje
1	Bashkia Shkodër	113,501	36,406
2	Ana e Malit	5,951	1,629
3	Berdicë	9,569	2,590
4	Dajç	8,961	2,236
5	Guri i Zi	11,725	3,301
6	Postribë	11,682	3,007
7	Pult	3,207	913
8	Rethina	23,616	6,936
9	Shalë	5,878	1,940
10	Shosh		
11	Velipojë	9,543	2,583
Popullsia totale		203,633	61,541

2. *“Fans”, që është shuma e të apasionuarve të klubit, e mbledhur me numrin e fansave në facebook .*

Emrat e faqeve dhe fansate klubit që ndjekin edhe përmes rrjeteve sociale është afërsisht si më poshtë:

KF Vllaznia Faqja zyrtare	12.379 ndjekës
KF Vllaznia Shkodër	27.099 ndjekës
Unë s’kam zemër, kam Vllazni	10.490 ndjekës
Vllaznit Ultras	39.608 ndjekës

Këtyre i duhen shtuar edhe shumë faqe të tjera, por që kanë një numër më të vogël fansash. Gjithsesi, në total mund të jenë rreth **100.000 ndjekëstë Vllaznisë** online përmes rrjeteve sociale si Facebook, Twitter, Instagram etj.

FAnsa w Klubit “Vllaznia” janë edhe pjesë e komunitetit emigrant tw cilwt e ndjekin ekipin në vazhdimësi.

3. “Stadium“ që është prodhimi mes numrit mesatar të spektatorëve për ndeshje me përqindjen e mbushjes së impiantit (stadiumit).

Kapaciteti i stadiumit “Loro Boriçi” aktualisht është 15.970 vende. Numri i tifozëve të Vllaznisë të pranishëm në ndeshjet e këtij sezoni 2016-2017 ka një mesatare prej 2000 tifozësh për ndeshje. Periudha e gjatë e rikonstruktimit të stadiumit “Loro Boriçi” gjatë këtyre viteve të fundit ka ndikimin e vet në shifrat e këtij edicioni, ku Vllaznia është rikthyer të luajë përsëri në stadiumin e vet.

Gjithsesi, kanë pësuar rritje të dukshme javët e fundit, mesatarisht rreth 2500-3000 tifozë të pranishëm në stadium, duke premtuar kështu përsëri një rritje dhe interesim nga publiku për t’u rikthyer e ndjekur Vllazninë. Vllaznia ka treguar të ketë gjithmonë numrin më të madh të tifozëve dhe kulturën sportive.

4. “HistPart” që është shuma e numrit të pjesëmarrjeve në superligë, kupat e Europës etj.

- Pjesëmarrja e KF. Vllaznia në Kupat e Europës

Sezoni	Kupat e Europës	Turni	Shteti	Klubi i Futbollit	Brenda	Jashtë
1978–79	UEFA European Cup	1T		Austria Wien	2–0	1–4
1987–88	UEFA Cup Winners' Cup	1T		Sliema Wanderers	2–0	4–0
		2T		RoPS	0–1	0–1
1991–92	UEFA Cup	1T		AEK Athens	0–1	0–2
1998–99	UEFA Champions League	1T		FC Dinamo Tbilisi	3–1	0–3
1999–00	UEFA Cup	1T		Spartak Trnava	1–1	0–2
2000-01	UEFA Intertoto Cup	1T		Nea Salamis FC	1–2	1–4
2001–02	UEFA Champions League	1T		KR Reykjavik	1–0	1–2
		2T		Galatasaray	1–4	0–2
2003–04	UEFA Cup	T		Dundee FC	0–2	0–4
2004-05	UEFA Intertoto Cup	1T		Hapoel Beer Sheva	1–2	3–0
		2T		NK Slaven Belupo	1–0	0–2
2007-08	UEFA Intertoto Cup	1T		NK Zagreb	1–0	1–2
		2T		Trabzonspor	0–4	0–6
2008–09	UEFA Cup	1T		FC Koper	0–0	2–1
		2T		S.S.C. Napoli	0–3	0–5
2009–10	UEFA Europa League	1T		Sligo Rovers	1–1	2–1

		2T		Rapid Wien	0-3	0-5
2011-12	UEFA Europa League	1T		Birkirkara F.C.	1-1	1-0
		2T		FC Thun	0-0	1-2

Parku i lojtareve: Të dhënat janë të publikuara në faqen e internetit <https://www.vllaznia.al/>

Këtu do të jepen të dhënat që ndihmojnë në kalkulimin e vlerës së lojtarëve

1. Numri total i lojtarëve dhe numri sipas rolit. Numri total i lojtarëve për sezonin 2017-2018 është 25 lojtarë.

Mosha mesatare e lojtarëve për sezonin '16-'17-'18 është 25.4 vjeç duke garantuar një të ardhme të sigurtë për KF Vllaznia. Me sicilin anëtar të stfsfit teknik, mbështetës dhe lojtarët Klubi I Futbollit "Vllaznia" ka kontrata të rregullta pune, me afate dhe pagesa të përcaktuara qartë.

Ekipe të zinxhir të KF.Vllaznia

Kualitetet e këtyre ekipeve ofrojnë sigurinë se e ardhmja e futbollit shkodran është e sigurtë, gjë të cilën e konfirmojnë edhe rezultat e siguruar së fundi gjatë sezonit 2016-2017 nga ekipet zinxhir.



Sportistët e ekipit U-19 pas shpalljes kampion të grupit A janë shpallur edhe kampion të të gjithë Shqipërisë. Ka ndodhur kështu pas përfundimit të finales ndaj Partizanit, finale kjo që u luajt në stadiumin "Elbasan Arena". Një sukses i merituar i këtij ekipi, i futbollistëve të tij, i trajnerëve Elvin Beqiri dhe Albert Kaçi por edhe i drejtuesve të Akademisë dhe atyre të klubit të cilët shohin veten të kurorëzohen si më të mirët e Shqipërisë për këtë grupmoshë.

Akademia Vllaznia ka siguruar edhe dy tituj të tjerë kampion, pas përfundimit të Kampionatit të Ligës Amatore të Zonës së Veriut. Ekipet U-16 dhe U-12 kanë dominuar ndaj kundërshtarëve të tyre dhe janë vlerësuar kështu si më të mirët e kampionatit duke marrë edhe kupat përkatëse.

Ekipi U-16 i drejtuar nga trajnerët Nefail Zhejani dhe Denis Zmijani, kanë luajtur në finale ndaj ekipit të Shkodrës dhe kanë fituar me rezultatin e thellë 5-0. Një dominim absolut i këtij ekipi i cili ndonëse me futbollistë të një datëlindje më të vogël, kanë arritur të triumfojnë ndaj të gjithë rivalëve dhe të shpallen kampionë të kategorisë U-17.

Finalja e kategorisë U-13 është luajtur në mes dy ekipeve të Akademisë tonë, atij U-12 të drejtuar nga trajneri Luan Zmijani dhe atij U-13 të drejtuar nga Astrit Prençi. Kanë fituar të parët 2-1 duke u shpallur kampionë të kësaj grupmoshe.

Sigurisht që këto janë të tjerë suksese të Akademisë tone, që përveç se nxjerr lojtarë të talentuar, fiton edhe tituj të shumtë kampionë.

Akademia konsiderohet një nga pikat më të forta të klubit të futbollit "Vllaznia". Kjo ngaqë Shkodra gjithmonë është shquar për nxjerrjen e elementëve cilësorë të cilët kanë mbushur ekipin e parë të Vllaznisë por edhe ekipet kombëtare. Struktura e akademisë është krijuar me

ekipe për çdo datëlindje duke marrë kështu përvojën e shumë Akademive të njohura nëpër Europë dhe Botë. Kjo është bërë me qëllim realizimin e një punë më cilësorë me elementin e ri në mënyrë që çdo ekip të mos ketë shumë futbollistë në rradhët e tij dhe t'i jepet mundësia çdonjërit prej tyre të tregojë vlerat e veta.

Aktualisht Akademia Vllaznia ka këtë numër lojtarësh:

U - 10 A	U – 14 B
U – 10 B	U – 15 ka në përbërje 24 lojtarë
U – 12 ka në përbërje 17 lojtarë	U- 16 ka në përbërje 26 lojtarë
U – 13 ka në përbërje 18 lojtarë	U- 17 ka në përbërje 25 lojtarë
U – 14 A	U- 19 ka në përbërje 21 lojtarë

